

Procesverbal

Nga Mbledhja III (e tretë) e rregullt për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 30.03.2026

Rend Dite

1. **Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e tretë të rregullt; dhe**
3. **Eventuale.**

Resul Fetahu: Përshëndetje kryetar, kolegë delegatë, OSBE, të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e III-të të rregullt të KPF-së për vitin 2026. Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë, ku i kemi dy pika të rendit të ditës dhe për seancë janë paraparë pesë pika të rendit të ditë dhe pika eventuale. A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë kush është për rendin e ditës të KPF-së? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, a do dikush me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe procesverbalin e seancës së kaluar.

Vazhdojmë me pikën e dytë të shqyrtimit të materialit të Kuvendit, me miratimin e planit të punës së KKSB-së për vitin 2026. Kush don me marrë fjalën? Z.Artan Loshaj e ka fjalën.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë. I nderuar kryesues, edhe në seancën e kaluar por edhe më herët kam kërkuar që materialin e seancës, për shkak të materialit të bollshëm që e kemi për afërsisht 200 faqe, kam kërkuar që të kemi kopje fizike, se me laptop nuk mund të dalë këtu për të diskutuar. Më herët ka kërkuar edhe kolegja z.Xhylferia që sallën me rregullue, sepse p.sh.: unë nuk jam i gatshëm që nesër të diskutoj, pasi që janë 200 faqe në pyetje. Kam kërkuar edhe më herët, por ju keni heshtur. Së paku nesër ta kemi përpara nga një mikrofon dhe laptopin përpara në mënyrë që të mund të diskutojmë dhe mos të dalim për secilën pikë në foltore. Nuk e di sa ju kushton juve me na bo kopje fizike, ose së paku me na bo kushte që ne të punojmë. Unë si asambleist në vend se me marrë kopje nga shërbimi i Kuvendit, unë tash si asambleist duhet me dal me bo kopjen nëpër Dragash. Ose nesër na sillni mikrofonin, ose së paku ndërtone sallën, se ka qenë edhe kërkesë e delegatës së juaj. Për shkak që kam punë familjare tash kërkoj që të largohem, ju vazhdoni, ju faleminderit.

Resul Fetahu: Falemnderit Artan. A don dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim a ka? Atëherë konstatojmë se me 6 vota për, zero kundër dhe zero abstenim miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë, propozim vendimi për miratimin e raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në infrastrukturë publike. Kush do me marrë fjalën? Nëse nuk ka, e hedhim në votim. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim a ka? Konstatojmë se me 6 vota për, zero kundër dhe zero abstenim miratohet edhe kjo pikë.

Vazhdojmë me pikën e katërt, propozim vendimi për miratimin e raportit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në ekonomi familjare. A don dikush me marrë fjalën? Nëse nuk ka, e çesim në votim. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim a ka? Atëherë konstatojmë se me 6 vota për, zero kundër dhe

zero abstënim miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e pestë, miratimi i raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2025 dhe plani i punës për vitin 2026. A don dikush me marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? Kush është kundër? A ka abstënim? Konstatohet se me 6 vota për, zero kundër dhe zero abstënim miratohet edhe kjo pikë.

Para se të kalojmë në pikën e fundit, e kemi një kërkesë të organizatës së veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mirëpo ata kanë kërkuar shumën në vlerë prej 4000 eurove, mirëpo ne për shkak të ligjit nuk kemi të drejtë mbi 2000 euro. Atëherë kush do me marrë fjalën?

Uran Halimi: Faliminderit kryesues. Meqenëse edhe pse jam djali i veteranit, kisha kërkuar me bo një kërkesë për raportin financiar dhe arsyet pse janë duke i kërkuar këto 2000 euro. Nuk jam kundër kësaj. Edhe vitin e kaluar kam thënë se këta i meritojnë shumë më shumë se sa 2000 euro. Mirëpo, a ka mundësi që prej organizatës së veteranëve të luftës që të na sjellin një raport financiar për 2000 euro vitin e kaluar që j'au kemi lëshuar edhe arsyen se pse ne duhet t'i lëshojmë këto 2000 euro, ne e dimë se aty paguhet anëtarësia dhe kanë buxhet. Në fshatin Shajne e kam parë se edhe aty po ndërtohet një memorial, a kanë lëshuar aty pare a po kërkojnë para për atë, apo çka është në pyetje, ne nuk e dimë dhe jemi pro kësaj. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: Atëherë po e lexojë edhe kërkesën e Vetranëve të Luftës.

Të nderuar, Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Dragash, në kuadër të aktiviteteve të saj, ka planifikuar shenimin e disa datave me rëndësi kombëtare dhe historike, si më poshtë:

- Epopeja e UÇK-së - 5, 6 dhe 7 Mars
- Dita e Dëshmorëve - 5 Maj
- Dita e Çlirimit të Komunës sonë - 12 Qershor
- Dita e Flamurit - 28 Nëntor
- Dita e Veteranit - 30 Dhjetor

Për secilen nga këto data të rëndësishme do të organizohen aktivitete perkujtimore, akademi solemne, homazhe tek varrezat e dëshmoreve, si dhe tubime me qytetare, familjarë të dëshmoreve dhe ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto aktivitete synohet të përcillet mesazhi i respektit dhe kujtimit për të gjithë ata që sakrifikuuan për lirinë e vendit tonë, si dhe të edukohen generatat e reja mbi vlerat e luftës Çlirimtare.

Duke pasur parasysh rëndësinë e organizimit të këtyre ngjarjeve dhe faktin se OVL e UÇK-së nuk ka burime të mjaftueshme financiare për të mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme, ju drejtohem me këtë kërkesë për mbështetje. Kjo ndihmë do të mundësonte mbulimin e shpenzimeve për logjistike, materiale perkujtimore, transport, dekorime dhe aktivitete të tjera që do të realizohen me këtë rast.

Prandaj, duke vlerësuar perkrahjen tuaj të mëparshme dhe rëndësinë e këtyre aktiviteteve për komunitetin tonë, ju lutemi që brenda mundësive buxhetore të na ndahen mjete financiare në vlerë prej 4,000€. Kjo shumë do të ndihmonte në realizimin dinjitoz të këtyre ngjarjeve dhe do të siguronte një organizim sa më të mirë të tyre.

Ju falënderojmë për mbështetjen e vazhdueshme dhe për bashkëpunimin e deritanishëm. Me shpresën se kjo kërkesë do të gjejë mirëkuptimin tuaj, presim me respekt pergjigjen tuaj pozitive.

Uran Halimi: Unë e di që këto mbledhjet solemne i organizon Komuna, a po? Edhe shpenzimet, edhe transportin e di që e mbulon Komuna, por në qoftë se ju, ju keni premtuar

që ja u japim, atëherë s'është problem. Por, të paktën një raport financiar për 2000 euro që j'au kemi lëshuar vitin e kaluar. Të lutem, është e vetmja kërkesë, vetëm që ta sjellin raportin financiar të shpenzimeve të vitit të kaluar. Edhe unë jam pro, jo për 2000, por edhe për 20,000 nuk është problem. Mirëpo, ta dimë ku po shkojnë ato mjete, sepse kërkesën të cilën ata e kanë bërë, me sa e di unë, janë ato shpenzime të cilat mbulohen nga ana e Komunes. Nëse nuk është e vërtetë, atëherë më thuani. Ju faleminderit.

Bexhet Xheladini: Përsëritet për të gjithë, siç e dini nga viti i kaluar, komiteti ka vendosur që kësaj organizate t'i ndihmojë me nga dy mijë euro. Tri vitet e para të qeverisjes sonë, ne i kemi ndihmuar me më pak se një mijë euro. Dy mijë euro për një organizatë të veteranëve nuk janë të mjaftueshme. Arsyeja është se, edhe pse është e vërtetë që shumicën e aktiviteteve që i përmendët i mbulon komuna, për funksionimin e zyrës nevojiten mjete. Duhet ta dini se ata pothuajse çdo ditë kanë vizitorë, dhe këtyre vizitorëve duhet t'u ofrohet të paktën një kafe apo një çaj. Kryetari dhe punëtorët e tjerë aty nuk kanë paga. Edhe sekretari i OVL-së së UÇK-së udhëton, por edhe këto mjete janë të pakta, ndërsa ligji nuk lejon më shumë. Është mirë që ata të përgatisin një raport financiar për mënyrën se si janë shpenzuar mjetet. Megjithatë, unë mendoj se shumica e tyre janë shpenzuar për reprezentacion. Për shembull, sot ata kanë shkuar në Prishtinë, dhe kur shkon atje, normalisht duhet të konsumosh diku një kafe apo çaj. Ata nuk kanë paga dhe e meritojnë këtë mbështetje. Jo vetëm kaq, por meritojnë edhe më shumë, sepse lirinë që e gëzojmë sot e kemi falë luftës së tyre në tokë dhe NATO-s në ajër. Është normale që të ketë transparencë, por këto mjete nuk duhet të na dhimbsen. Ju faleminderit.

Uran Halimi: Në fillim e thashë që e meritojnë shumë më shumë, nuk është problem ajo. Problemi është, sepse ne subvencionojmë edhe OJQ që ndoshta hiq ose as pak nuk janë meritore. Mirëpo e gjitha, ajo çfarë kërkonte unë është një raport financiar. Unë kisha preferuar që ata me specifikum saktësisht se për çka i shpenzojnë ato para. Do të thotë se ata kanë mundur t'i ndajnë këto para nëpër kolona, por duhet ta kemi parasysh se këto janë para të popullit dhe për to duhet të japim llogari. Po të ishin para personale, askush nuk do të kërkonte llogari, le t'i shpenzonin si të donin. Mirëpo këto janë para të qytetarëve dhe ne kemi obligim t'i arsyetojmë. Edhe vetë ata e dinë që duhet të jenë transparent në këtë rast. Sa i përket shumës, unë nuk e kam problem nëse janë 2000 apo 4000 euro. Nëse ju mendoni ndryshe, në një komitet tjetër mund t'u ndajmë edhe 2000 euro shtesë — pra me dy komitete nga 2000 bëhen 4000. Por ajo që më intereson mua është transparenca. Duhet ta saktësojmë këtë, sepse nuk mund të votojmë vetëm që ato mjete të shpenzohen pa kontroll. Sa i përket pagave apo prezencës së tyre në zyrë, kjo nuk është çështje e jona, sepse ne si kuvend komunal nuk e kemi themeluar atë organizatë. Ata vetë e dinë si është themeluar dhe si funksionon. Mua më intereson vetëm transparenca — të dimë se ku po shkojnë paratë e qytetarëve. Pjesën tjetër, luftën e tyre, e respektoj dhe e admirojmë shumë. Në fakt, të gjithë kemi përjetuar vështirësitë e luftës. Na kanë munguar baballarët dhe familjarët që kanë shkuar dhe kanë dhënë jetën në atë luftë. Për këtë, jam shumë falënderues dhe përulëm para sakrificës së tyre. Por pikërisht për mirëqenien tonë dhe për transparencë, veteranët duhet të jenë transparent, sepse kanë luftuar për demokraci dhe transparencë. Unë po kërkoj transparencë, pikërisht për ta respektuar dhe për ta përmbushur atë sakrificë. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: A don ndonjë kush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatojmë se me 6 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo kërkesë. Kalojmë në pikën e gjashtë, në pikën eventuale. A don dikush me marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë e mbylлим këtë seancë. Shihemi nesër në Seancën e Kuvendit.